FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 80 — 13 korrik — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 65/2012 datë 7.6.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", të ndryshuar……	3653
Ligj nr. 66/2012 datë 7.6.2012	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", të ndryshuar……	3653
Ligj nr. 67/2012 datë 14.6.2012	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Kroacisë……	3663
Rezolutë e Kuvendit datë 7.6.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2011……	3666
Rezolutë e Kuvendit datë 14.6.2012	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011……	3667
Rezolutë e Kuvendit datë 14.6.2012	Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2011……	3668
Dekret nr. 7534 datë 11.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3669
Dekret nr. 7540 datë 13.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3670
Dekret nr. 7546 datë 22.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3670

Dekret nr. 7551 datë 25.6.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare……	3671
Udhëzim i MPPT nr. 6 datë 15.6.2012	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 28.3.2012 "Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR"……	3672
Urdhër i MD nr. 4217/2 datë 25.6.2012	Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licencimin e administratorëve të falimentit……	3673

LIGJ
Nr. 65/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8734, DATË 1.2.2001 "PËR GARANTIMIN E SIGURISË SË PUNËS TË PAJISJEVE DHE TË INSTALIMEVE ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike", të ndryshuar, shkronja "b" e nenit 13 shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2012.

Shpallur me dekretin nr. 7580, datë 28.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 66/2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9917, DATË 19.5.2008 "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

[1] *Ky ligj është përafruar plotësisht me:*
Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit nr. 2005/60/KE, datë 26 tetor 2005 "Mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit". Numri CELEX 32005L0060, Fletore Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L nr. 309, datë 25.11.2005, faqe 15-36.

Neni 1

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4, fjalët “230/d të Kodit Penal” zëvendësohen me fjalët “230/ç të Kodit Penal”.

2. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Instrumente të negociueshme të mbajtësit” përfshijnë instrumentet monetare në formën e mbajtësit në pronësi të këtij të fundit, të tilla si çeqet e udhëtarit; instrumentet e negociueshme (ku përfshihen, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), që janë në formën e mbajtësit, të vlefshme, pa u kufizuar nga personi të cilit i paguhet, të paguara një personi fiktiv ose përndryshe në një formë që pronësia kalohet thjesht nëpërmjet dorëzimit nga një person te një tjetër; instrumentet jo të plota (përfshirë, por pa u kufizuar në çeqet, premtimpagesat dhe urdhërpagesat), të nënshkruara, por pa përfshirë emrin e personit të cilit i paguhet.”.

3. Pika 10 riformulohet si më poshtë:

“10. “Personat e ekspozuar politikisht” janë personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi.”.

4. Në fjalinë e parë të pikës 12 shprehja “ose juridik” hiqet.

5. Pas pikës 19 shtohet pika 19/1 me këtë përmbajtje:

“19/1 “Vigjilenca e duhur” është tërësia e masave që duhet të aplikojnë subjektet, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.”.

6. Pas pikës 22 shtohen pikat 23 dhe 24 me këtë përmbajtje:

“23. “Llogari transitore” është llogaria korrespondente që përdoret në mënyrë të drejtpërdrejtë nga palët e treta për të kryer transaksione biznesi në emër të tyre.

24. “Organizime ligjore” janë trustet apo marrëveshjet e tjera të ngjashme.”.

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “gj”, pas fjalëve “avokatët, noterët, përfaqësues të tjerë ligjorë” shtohen fjalët “ekspertët kontabël të autorizuar të pavarur, kontabilistët e miratuar të pavarur, zyrat e konsulencës financiare dhe”.

2. Në fund të nënndarjes “iv” të shkronjës “gj” shtohen fjalët “dhe/ose organizimeve ligjore”.

3. Shkronja “i” shfuqizohet.

4. Në shkronjën “k” bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas nënndarjes “i” shtohet nënndarja “i/1” me këtë përmbajtje:

"i/1) themelimin, regjistrimin, administrimin, funksionimin e organizimeve ligjore apo personave juridikë, që nuk përfshihen në shkronjën "gj";".

b) Nënndarja "vii" ndryshohet si më poshtë:

"vii) shitblerjen e veprave të artit apo shitblerjen me ankand të sendeve me vlerë 1 000 000 (një milion) lekë ose më shumë.".

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4
Rastet kur kërkohet vigjilenca e duhur

Subjektet duhet të marrin masat e vigjilencës së duhur ndaj klientit në rastet e mëposhtme:

a) para se të vendosin një marrëdhënie biznesi;

b) kur klienti, në raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike, kryen ose kërkon të kryejë:

i) një transfertë brenda ose jashtë vendit apo një transaksion në një shumë të barabartë ose më të madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të huaja, për subjektet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "g" të nenit 3 të këtij ligji, si dhe subjektet e tjera që kryejnë shërbime transfertash, këmbimi valutor apo lojëra fati;

ii) një transaksion me një shumë të barabartë me jo më pak se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera të huaja, kryer në një transaksion të vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëri-tjetrin. Nëse shuma e transaksioneve nuk dihet në kohën e veprimit, identifikimi duhet të kryhet sapo të bëhet e ditur shuma dhe të arrihet pragu i mësipërm;

c) kur ka dyshime për vërtetësinë e të dhënave të identifikimit të marra më parë;

ç) në të gjitha rastet, pavarësisht nga limitet e raportimit, të parashikuara në këtë nen, kur ka dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.".

Neni 4

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Masat e vigjilencës së duhur

1. Në kuadrin e ushtrimit të vigjilencës së duhur ndaj klientit, subjektet duhet:

a) të identifikojnë klientin (të përhershëm apo rastësor, person fizik, juridik apo organizime ligjore) dhe të verifikojnë identitetin e tij nëpërmjet dokumenteve, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura;

b) për klientët që janë persona juridikë ose organizimet ligjore:

i) të verifikojnë nëse çdo person që vepron në emër të klientit të tij është i autorizuar dhe të identifikojnë dhe të verifikojnë identitetin e tij;

ii) të verifikojnë statusin e tyre ligjor, nëpërmjet dokumenteve të themelimit, të regjistrimit ose fakteve të ngjashme të ekzistencës së tyre, si dhe të sigurojnë informacion për emrin e klientit, emrat e të mirëbesuarve (për organizimet ligjore), formën ligjore, adresën, drejtuesit dhe/ose përfaqësuesit ligjorë (për personat juridikë) dhe dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet juridike;

c) të identifikojnë pronarin përfitues dhe të marrin masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin e tij, nëpërmjet informacioneve ose të dhënave të siguruara nga burime të besueshme, në bazë të të cilave subjekti sigurohet për identitetin e tij;

ç) të përcaktojnë për të gjithë klientët, para vendosjes së marrëdhënieve të biznesit, nëse ata janë duke vepruar në emër të një personi tjetër, dhe të marrin masa të arsyeshme për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për identifikimin dhe verifikimin e atij personi;

d) të kuptojnë strukturën e pronësisë dhe kontrollit për klientët që janë persona juridikë apo organizimet ligjore;

dh) të përcaktojnë se cilët janë individët, të cilët zotërojnë apo kontrollojnë klientin, përfshirë ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv mbi personin juridik apo organizimin ligjor;

e) të mbledhin informacion për qëllimin dhe natyrën e marrëdhënies së biznesit dhe të zhvillojnë profilin e riskut gjatë monitorimit të vazhdueshëm;

ë) të kryejnë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin, përfshirë analizimin e transaksioneve të kryera gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për klientin, natyrën e biznesit të tij, profilin e riskut, si dhe burimin e fondeve;

f) të sigurohen, nëpërmjet rishikimit të dosjeve të klientëve, që dokumentet, të dhënat dhe informacioni i mbledhur gjatë procesit të vigjilencës së duhur janë përditësuar, janë të vlefshme dhe të përshtatshme, veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me risk të lartë;

g) të verifikojnë identitetin e klientit dhe pronarit përfitues përpara ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit ose kryerjes së një transaksioni për klientët rastësorë. Verifikimi i identitetit të klientit dhe pronarit përfitues mund të kryhet pas vendosjes së marrëdhënies së biznesit, me kusht që:

i) të realizohet sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur;

ii) të mos ndërpritet zhvillimi normal i aktivitetit të biznesit;

iii) rreziqet e pastrimit të parave të menaxhohen në mënyrë efektive nga subjekti.

gj) të përcaktojnë procedurat e menaxhimit të riskut që do të zbatohen për rastet kur një klient mund të lejohet të përdorë marrëdhënien e biznesit përpara ose gjatë plotësimit të procesit të verifikimit.

Këto procedura, ndër të tjera, duhet të përfshijnë masa për kufizimin e numrit, të llojit dhe/ose të shumës së transaksioneve që mund të kryhen, si dhe monitorimin e transaksioneve, në vlera të larta apo komplekse, të kryera jashtë profilit të pritshëm për veçoritë e kësaj marrëdhënieje;

h) të plotësojnë detyrimet e sipërpërmendura edhe për klientët ekzistues, duke u bazuar në prova, fakte dhe rrezikun e ekspozimit ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e duhur ndaj klientit, sipas këtij neni dhe neneve 4 e 5 të këtij ligji, duhet:

a) të mos hapin llogari, të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi;

b) nëse ka filluar marrëdhënia e biznesit, ta ndërpresin atë;

c) t'i dërgojnë raport për aktivitet të dyshimtë "autoritetit përgjegjës";

ç) të mos hapin apo të mos mbajnë llogari anonime, me emra fiktivë ose të identifikuara vetëm nëpërmjet një numri apo kodi, përfshirë depozitat apo instrumentet e tjera të mbajtësit. Nëse ka llogari të tilla, klientët e tyre duhet të identifikohen dhe të verifikohen, sipas parashikimeve të këtij neni. Nëse kjo nuk arrihet, llogaria duhet të mbyllet dhe t'i dërgohet raport për aktivitet të dyshimtë "autoritetit përgjegjës"".

Neni 5

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 6
Zhvillimet teknologjike dhe palët e treta

1. Subjektet duhet të zbatojnë politika dhe të marrin masat e duhura, sipas rastit, për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me:

a) zhvillimet e produkteve të reja, praktikat e biznesit, mënyrat e ofrimit apo kanalet e shpërndarjes;

b) përdorimin e teknologjive të reja apo atyre që janë në zhvillim.

Këto masa duhet të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja, praktikave të biznesit apo teknologjive të reja, në mënyrë që të administrohen dhe të ulen rreziqet e identifikuara.

2. Subjektet duhet të zbatojnë procedura specifike dhe të marrin masat e duhura e të efektshme për të parandaluar rrezikun që lidhet me transaksionet apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.

3. Masat e vigjilencës së duhur duhet të zbatohen nga vetë subjektet e këtij ligji dhe mbështetja në palë të treta nuk është e lejuar.".

Neni 6

Në nenin 7 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Vigjilenca e zgjeruar duhet të përfshijë masa shtesë, përveç atyre të parashikuara për vigjilencën e duhur, për marrëdhëniet e biznesit, klientët apo transaksionet me rrezik të lartë. Për zvogëlimin e rrezikut të pastrimit të parave, krahas kategorive të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, subjektet përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilave duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar.".

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Kur subjektet janë të paafta që të plotësojnë detyrimet për vigjilencën e zgjeruar ndaj klientit, sipas neneve 7, 8, dhe 9 të këtij ligji, ato duhet të zbatojnë masat e parashikuara në pikën 13 të nenit 4/1 të këtij ligji.".

Neni 7

Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët "Subjektet e përcaktuara në shkronjën "a" të nenit 3 të këtij ligji, përveç procedurave të vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, duhet:" zëvendësohen me fjalët "Për personat e ekspozuar politikisht, subjektet duhet:".

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4, 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:

"4. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientët jorezidentë, veçanërisht kur këto transaksione kryhen pa praninë fizike të klientit.

5. Subjektet duhet të verifikojnë dhe t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me të gjitha kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet përkatëse ndërkombëtare, për të parandaluar e luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, për një periudhë 5-vjeçare, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës dhe audituesve, nëse kërkohet.

6. Subjektet duhet t'u kushtojnë vigjilencë të zgjeruar marrëdhënieve të biznesit dhe transaksioneve me klientë, siç janë trustet dhe shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit.".

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, ndaj të cilave zbatohet vigjilenca e zgjeruar

1. Subjektet duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha transaksioneve komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor. Subjektet duhet të analizojnë arsyet dhe qëllimin e kryerjes së transaksioneve të tilla dhe të mbajnë të dhëna me shkrim për konkluzionet, për një periudhë 5-vjeçare, të cilat duhet t'u vihen në dispozicion autoritetit përgjegjës dhe audituesve, nëse kërkohet.

2. Për shërbimet bankare korrespondente ndërkufitare, të ofruara nga bankat subjekte të këtij ligji, përpara se të vendosin një marrëdhënie biznesi, ato duhet:

a) të grumbullojnë informacion të mjaftueshëm rreth institucionit pritës, për të kuptuar plotësisht natyrën e biznesit;

b) të përcaktojnë, nëpërmjet informacionit publik, reputacionin e institucionit pritës, cilësinë e mbikëqyrjes së tij, përfshirë faktin nëse ka qenë subjekt hetimi apo masash administrative që lidhen me pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit;

c) të vlerësojnë se procedurat e kontrollit të brendshëm të institucionit pritës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë të mjaftueshme dhe efektive;

ç) të marrin miratimin e instancave më të larta të administrimit/drejtimit dhe të dokumentojnë respektivisht për çdo institucion përgjegjësitë për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit;

d) të hartojnë procedura të veçanta për monitorimin e vazhdueshëm të transaksioneve të drejtpërdrejta elektronike.

3. Subjekteve u ndalohet që të vendosin apo të vazhdojnë marrëdhënie bankare korrespondente me banka guaskë.

4. Subjektet duhet të marrin masat e duhura, në mënyrë që të krijojnë bindjen se bankat e huaja korrespondente nuk lejojnë që llogaritë e tyre të përdoren nga bankat guaskë. Subjektet duhet të ndërpresin marrëdhëniet e biznesit dhe t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, kur vlerësojnë se llogaritë e bankës korrespondente përdoren nga bankat guaskë.

5. Për rastet kur marrëdhënia korrespondente përfshin mbajtjen e llogarive transitore, subjektet duhet të sigurohen që banka korrespondente:

a) ka ndërmarrë masat e vigjilencës së duhur për klientët që kanë akses të drejtpërdrejtë në këto llogari;

b) është në gjendje, nëse i kërkohet, të paraqesë dokumentet e identifikimit të klientit.".

Neni 9

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të marrin dhe të identifikojnë emrin, mbiemrin, adresën, numrin e dokumentit të identifikimit ose numrin e llogarisë së dërguesit, përfshirë emrin e institucionit financiar nga ku niset transferta.

Informacioni duhet të përfshihet në formularin e mesazhit ose të pagesës që shoqëron transfertën. Në rast se nuk ka një numër llogarie, transferta shoqërohet nga një numër unik reference.".

2. Në pikën 3, fjalët "ose nga përfituesi" hiqen.

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Subjektet, veprimtaritë e të cilave përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të mbajnë një listë të agjentëve që operojnë për llogari të tyre dhe ta vënë në dispozicion të autoritetit përgjegjës, autoriteteve mbikëqyrëse dhe audituesve, nëse kërkohet. Për qëllim të këtij ligji, këta agjentë do të konsiderohen si pjesë e subjektit, i cili duhet t'i trajnojë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe të sigurohet që ata zbatojnë të njëjtat masa të vigjilencës së duhur ndaj klientit, mbajtjes së të dhënave dhe raportimit.".

Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronjat "b" dhe "e" të pikës 1 ndryshohen si më poshtë:

"b) të emërojnë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, në nivele administrimi/drejtimi në zyrën qendrore dhe në çdo zyrë përfaqësimi, filial, degë ose agjenci, te të cilat të gjithë punonjësit raportojnë çdo fakt që mund të përbëjë dyshim për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe të përcaktojnë procedura të përshtatshme menaxhimi e përputhshmërie, brenda subjektit dhe degëve. Personat përgjegjës kanë akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave, të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.".

"e) të sigurohen se filialet, degët dhe nëndegët, si dhe agjencitë e tyre, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe, në veçanti, në vende dhe territore, të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në këtë ligj. Në qoftë se masat parandaluese në dy vendet ndryshojnë, atëherë subjektet duhet të sigurohen që kanë përparësi detyrimet më të larta. Nëse ligjet e vendit, ku janë vendosur filialet, degët, nëndegët ose agjencitë, parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet t'i raportojë për këto pengesa autoritetit përgjegjës dhe, sipas rastit, autoritetit mbikëqyrës.".

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 11

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 12
Raportimi tek autoriteti përgjegjës

1. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

2. Kur subjekti, të cilit i kërkohet nga klienti të kryejë një transaksion, ka dyshime se transaksioni mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ai duhet të mos e kryejë transaksionin, t'ia raportojë menjëherë rastin autoritetit përgjegjës dhe të kërkojë udhëzime nëse duhet ta kryejë apo jo transaksionin. Brenda 48 orëve nga marrja dijeni, autoriteti përgjegjës kthen përgjigje, duke parashtruar qëndrimin për lejimin e transaksionit ose nxjerrjen e urdhrit të bllokimit. Kur autoriteti përgjegjës nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, subjekti mund të vazhdojë me kryerjen e transaksionit.

3. Subjekteve u kërkohet t'i raportojnë autoritetit përgjegjës, sipas afateve të përcaktuara në aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji, për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.".

Neni 12

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Mbrojtja e identitetit të subjektit raportues

Për raportimet e aktivitetit të dyshimtë, të cilat autoriteti përgjegjës i merr në zbatim të këtij ligji, është i detyruar të ruajë identitetin e subjekteve raportuese dhe të punonjësve të tyre që kanë raportuar.".

Neni 13

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
Kërkesat për mosdeklarim

Drejtuesve, zyrtarëve dhe punonjësve, të përkohshëm apo të përhershëm, të subjekteve, autoriteteve mbikëqyrëse apo institucioneve që u kërkohet të raportojnë pranë autoritetit përgjegjës, sipas këtij ligji, u ndalohet të informojnë klientin ose çdo person tjetër, për dërgimin apo përgatitjen për dërgim të informacionit për autoritetin përgjegjës, për raportimin e aktivitetit të dyshimtë, si dhe për çdo informacion që kërkohet nga ky i fundit apo për hetimet që janë duke u kryer.".

Neni 14

Neni 15/1 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "ç" ndryshohet si më poshtë:

"ç) mbikëqyr përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, përfshirë inspektimet, vetëm ose në bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse;".

2. Shkronja "ë" ndryshohet si më poshtë:

"ë) mban statistika të plota dhe raporton për procedimet penale të regjistruara për veprat penale të pastrimit të produkteve të veprave penale ose veprimtarisë kriminale dhe financimit të terrorizmit, si dhe për mënyrën e përfundimit të tyre;".

3. Në shkronjën "f", fjalët "në përputhje me pikën 5 të nenit 9 të këtij ligji," zëvendësohen me fjalët "në përputhje me pikën 5 të nenit 8 të këtij ligji,".

4. Pas shkronjës "k" shtohen shkronjat "l" dhe "ll" me këtë përmbajtje:

"l) urdhëron, kur ka arsye të bazuara për pastrim parash dhe financim terrorizmi, monitorimin, gjatë një periudhe të caktuar të veprimeve bankare që janë duke u kryer përmes një ose më shumë llogarish të përcaktuara;

ll) rishikon periodikisht efektivitetin dhe frytshmërinë e sistemit vendas për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes statistikave, vlerësimit të rrezikut dhe informacioneve të tjera të disponueshme. Për këtë qëllim, autoriteti përgjegjës kërkon statistika dhe të dhëna nga subjektet, autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet e tjera kompetente, që janë të ngarkuara për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në të cilat të paktën duhet të përfshihen:

i) raportet e aktivitetit të dyshimtë, të ndara sipas raportuesit, analizës dhe shpërndarjes;

ii) rezultatet e inspektimeve në vend, kundërvajtjet administrative të vendosura dhe të kategorizuara sipas llojit, sektorit dhe shumës;

iii) rastet e hetuara, personat e proceduar dhe të dënuar;

iv) pasuritë e bllokuara, të sekuestruara ose të konfiskuara;

v) kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe për bashkëpunim ndërkombëtar.".

Neni 16

Pas nenit 22 shtohet neni 22/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 22/1
Përdorimi i të dhënave

Çdo informacion apo e dhënë, e dërguar nga DPPP-ja për organet e zbatimit të ligjit, i nënshtrohet ligjit për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror dhe nuk përbën provë në kuptimin e Kodit të Procedurës Penale.".

Neni 17

Në nenin 24 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 shkronja "b" fjalët "shkronjat "dh", "e" dhe "ë" të nenit 3 të këtij ligji" zëvendësohen me fjalët "shkronjat "e" dhe "ë" të nenit 3 të këtij ligji".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Autoritetet mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet e parashikuara në nenet 4, 4/1, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 e 16 të këtij ligji. Për qëllimin e këtij ligji, pavarësisht nga parashikimet e ligjeve të tjera, autoritetet mbikëqyrëse mund të kërkojnë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të këtij ligji.".

3. Në pikën 4, pas shkronjës "a" shtohet shkronja "a/1" me këtë përmbajtje:

"a/1) informojnë në kohë dhe bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës, për çështjet e mospërputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve të tyre, masat përmirësuese që do të merren dhe masat administrative, nëse ka pasur.".

Neni 18

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 27
Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, shkeljet e kryera nga subjektet klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe për to subjektet gjobiten.

2. Për rastet kur nuk zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenet 4, 4/1, 5, 6, 11, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë: nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë;

b) personat juridikë: nga 300 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.

3. Për rastet kur nuk zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenet 7, 8, 9 dhe 10, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë: nga 200 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

b) personat juridikë: nga 400 000 lekë deri në 4 000 000 lekë.

4. Për rastet kur nuk zbatojnë kërkesat dhe afatet e parashikuara në aktet nënligjore, dalë në zbatim të këtij ligji, për raportim të transaksioneve mbi prag apo për raportim të aktivitetit të dyshimtë, të parashikuara në nenet 4/1, 9 dhe 12, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë: nga 300 000 lekë deri në 3 000 000 lekë;

b) personat juridikë: nga 500 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

5. Për rastet kur nuk zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenet 15 dhe 16 të këtij ligji, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë: nga 200 000 lekë deri në 1 500 000 lekë;

b) personat juridikë: nga 1 000 000 lekë deri në 4 000 000 lekë.

6. Për rastet kur nuk zbatojnë urdhrin e autoritetit përgjegjës, të nxjerrë, sipas nenit 22 shkronja “g”, subjektet gjobiten:

a) personat fizikë: nga 300 000 lekë deri në 2 000 000 lekë;

b) personat juridikë: nga 2 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.

7. Përveç sa parashikohet në pikat 2, 3, 4, 5 e 6 të këtij neni, kur subjekti është një person juridik dhe kundërvajtja administrative është kryer:

a) nga një punonjës ose jo administrues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 20 000 lekë deri në 200 000 lekë;

b) nga një administrator ose drejtues i subjektit, personi që ka kryer shkeljen gjobitet nga 50 000 lekë deri në 500 000 lekë.

8. Gjobat përcaktohen dhe vendosen nga autoriteti përgjegjës.

9. Autoriteti përgjegjës informon autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për sanksionet e vendosura.

10. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat e konstatimit, të shqyrtimit, të propozimit dhe të vendosjes së masave administrative nga autoriteti përgjegjës. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të gjobave, të vendosura me vendim të autoritetit përgjegjës, bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

11. E drejta për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative, të parashikuara në këtë nen, nuk mund të ushtrohet kur kanë kaluar 2 vjet nga çasti i kryerjes së kundërvajtjes administrative.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.6.2012.

Shpallur me dekretin nr. 7581, datë 28.6.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

LIGJ
Nr. 67/2012

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË KUNDREJT REPUBLIKËS SË KROACISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Kroacisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.6.2012

Shpallur me dekretin nr. 7600, datë 9.7.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KROACISË MBI SHLYERJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ REPUBLIKËS SË KROACISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë më poshtë të quajtura “palët”,

Me qëllim që:

- të zhvillojnë bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm ekonomik dhe financiar bazuar në parimet e përfitimeve të përbashkëta;
- të finalizojnë shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Kroacisë; dhe
- në pajtim me Memorandumin ndërmjet Këshillit të Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Serbisë, Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi shlyerjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë në lidhje

me shlyerjen e shumave në llogaritë sipas shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, të nënshkruar më 14 dhjetor 2010 në Tiranë, Shqipëri,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palë konfirmojnë që:

Gjendja përfundimtare për shlyerje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë, duke përfshirë interesin e rregullt të llogaritur për periudhën nga 31 marsi 2006 deri më 30 shtator 2009 arrin në 5,484,668.38 dollarë kleringu (me fjalë: pesë milionë, e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë e 38/100 dollarë kleringu).

Shuma e parashikuar në pikën 1 të këtij neni përbën borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Kroacisë në dollar kleringu të datës 30 shtator 2009.

Neni 2

Palët bien dakord që borxhi i llogaritur në USD, sipas parashikimit të nenit 1 pika 2, do të jetë i konvertueshëm në borxhin e llogaritur në dollarë amerikanë (USD), sipas kursit të këmbimit prej një dollar kleringu =1 dollar amerikan.

Neni 3

Palët bien dakord që në pajtim me nenin 2 më lart, borxhi i Republikës së Shqipërisë ndaj Republikës së Kroacisë në datën 30 shtator 2009 arrin në 5,484,668.38 USD (me fjalë: pesë milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë e 38/100 USD).

Palët, gjithashtu, bien dakord të zbatojnë normën e interesit për periudhën 30 shtator 2009 deri në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje në pajtim me Memorandumin.

Neni 4

Pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Ministria e Financave e Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të paguajë në llogarinë e specifikuar më parë nga Ministria e Financave e Republikës së Kroacisë, shumën totale të borxhit në mënyrën e mëposhtme:

Katër këste të barabarta gjysmëvjetore plus interesin e shtuar më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti, që këtu përcaktohen si data pagese;

Data e parë e pagesës së shumës principale dhe interesit është në datën që vjen menjëherë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Nëse 31 marsi ose 30 shtatori bie në ditë pushimi në secilin prej vendeve, data e pagesës do të jetë dita pasuese e punës.

Ministria e Financave e Shqipërisë në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë i paguan Ministrisë së Financave të Republikës së Kroacisë interesin e rregullt si më poshtë:

Interesi llogaritet bazuar në numrin faktik të ditëve që kanë kaluar dhe një vit me 360 ditë;

Norma e zbatueshme e interesit është 6 muaj LIBOR USD, që kuotohet nga Shoqata Britanike e Bankave rreth 11:00 paradite GMT dy ditë pune para periudhës përkatëse të interesit, që fillon më 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti;

Në pajtim me Memorandumin, interesi i shtuar për periudhën që fillon nga 30 shtatori 2009 deri në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje do të llogaritet me 6 muaj LIBOR USD sipas

parashikimit më sipër. Ky interes do të paguhet në datën e parë të pagesës së bashku me këstin e parë të shumës principale dhe interesin e shtuar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje deri në datën e parë të pagesës.

Interesi i zbatuar për pagesat e vonuara të shumës principale dhe interesat (kamatëvonesat) llogaritet me normën 6 muaj LIBOR USD plus 3 % në vit.

Neni 5

Palët bien dakord të zgjidhin me pajtim të gjitha mosmarrëveshjet, që rrjedhin nga kjo Marrëveshje në mënyrë miqësore me konsultimet e ndërsjella dhe negociatat.

Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në pajtim me paragrafin 1, palët bien dakord që mosmarrëveshja të zgjidhet përfundimisht në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër dhe këta dy anëtarë caktojnë një arbitër të tretë - Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit.

Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë një anëtar të tretë - Kryetarin e Gjykatës së Arbitrazhit, arbitri i tretë caktohet në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të përmendura më lart.

Vendimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe detyrues për të dyja palët dhe i zbatueshëm brenda afatit të specifikuar në vendim.

Palët bien dakord që arbitrazhi të zhvillohet në pajtim me procedurën e përcaktuar nga Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

Vendi i arbitrazhit do të jetë në Paris, Francë ose diku tjetër, nëse palët bien dakord që është e përshtatshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Gjuha e arbitrazhit është gjuha angleze.

Neni 6

Kjo Marrëveshje ndryshohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

Neni 7

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë Marrëveshje drejtohen si më poshtë:
Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit të Borxhit Publik
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel: + +35542228405
Faks: + +35542228494
Për Qeverinë e Republikës së Kroacisë:
Ministria e Financave
Drejtoria e Integrimit Europian dhe Marrëdhënieve Financiare Ndërkombëtare
Katanciceva 5, 10000 Zagreb, Republika e Kroacisë
Tel: + +385 1 459 1258
Faks: + +385 1 492 2598

Neni 8

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, që secila palë ka njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet rrugëve diplomatike, që procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përmbushur.

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të përmbushen të gjitha detyrimet e të dyja palëve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

Bërë në _____, më _____2011, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin kushtetues të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e pavarur të politikës monetare;

Duke njohur objektivat afatmesëm e vjetorë, si dhe detyrimet ligjore të institucionit;

Duke marrë në konsideratë ndikimin e zhvillimeve ekonomike botërore, rajonale e kombëtare në politikën monetare të ndjekur nga institucioni;

Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion,

Konstaton se gjatë vitit 2011 Banka e Shqipërisë:

- Ka ndjekur një politikë monetare të kujdesshme dhe efektive, duke krijuar kushte lehtësuese monetare për rritjen ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit makroekonomik e financiar të vendit.

- Ka realizuar objektivin e saj kryesor, ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke e mbajtur nivelin e inflacionit brenda kufijve të programuar.

- Ka harmonizuar politikën monetare me atë fiskale, duke rritur likuiditetin dhe stimulin monetar në ekonomi dhe duke nxitur zhvillimin e tregut të brendshëm financiar.

- Ka forcuar rolin mbikëqyrës dhe rregullator ndaj sistemit bankar e financiar, duke i dhënë përparësi rritjes së nivelit të kapitalit dhe të provigjoneve, me synim ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar.

- Ka ndikuar në rritjen e kreditimit të biznesit dhe reduktimin e kostove të tij, duke kontribuar në zgjerimin e investimeve të sektorit privat.

- Ka menaxhuar me ekonomi rezervën valutore, duke e investuar me efektivitet dhe ka ruajtur një normë optimale të saj.

- Ka luajtur rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe transparencën e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave.

- Ka ndikuar në rritjen e efiçencës dhe të qëndrueshmërisë së sistemeve të pagesave, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe zhvillimin e produkteve të reja të pagesave.

- Ka mbështetur proceset integruese të vendit tonë në BE dhe ka mbajtur marrëdhënie bashkëpunuese me institucionet kryesore financiare kombëtare e ndërkombëtare.

Kuvendi kërkon që, për vitin 2012, Banka e Shqipërisë të përqendrojë punën në këto drejtime:

- Vijimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, sipas objektivave të programit monetar.

- Thellimin e koordinimit të politikave monetare me ato fiskale, duke synuar mbështetjen e rritjes ekonomike, mbi bazën e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm afatmesëm dhe afatgjatë të saj.

- Forcimin e pavarësisë së vendimmarrjes dhe rritjen e profesionalizmit të stafit të institucionit, me synim rritjen e efektivitetit të vendimeve të politikës monetare.

- Forcimin e mbikëqyrjes së sistemit bankar e financiar, duke adaptuar rregullat dhe parimet më të forta për një mbikëqyrje të kujdesshme të veprimtarisë së sektorit, si dhe duke kërkuar nga sistemi bankar zbatimin e modeleve të suksesshme në menaxhimin e riskut.

- Aplikimin e politikave, si dhe bashkëpunimin me sistemin bankar për rritjen e masës, efektivitetit dhe përmirësimin cilësor të kreditimit, ndikimin me vendimmarrjen e saj në shëndoshjen e portofolit të kredive, duke asistuar riskedulimin e kredive me rregulla, udhëzime dhe procedura.

- Zgjerimin e bashkëpunimit dhe vendosjen e sistemit të raportimit elektronik nga subjektet financiare që raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë.

- Përafrimin e kuadrit rregullator dhe të praktikave të punës së institucionit me ato të Bankës Qendrore Europiane, si dhe sigurimin e mbështetjes teknike e profesionale për ndryshimet ligjore në fushën e ekzekutimit të kolateralit.

- Thellimin e punës studimore, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes së politikave ekonomike në njohjen empirike dhe praktikat më të mira, duke u fokusuar, veçanërisht, në përmirësimin e modelit makroekonomik dhe në aftësinë parashikuese të inflacionit dhe ndryshoreve të tjera makroekonomike.

- Përmirësimin e sasisë dhe cilësisë së statistikave të prodhuara nga institucioni, si dhe rritjen e transparencës ndaj publikut.

7 qershor 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës publike;

Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni të paanshëm për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës shtetërore, në nivel qendror e vendor, sistemit gjyqësor dhe prokurorisë, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna dhe masave të propozuara;

Duke mbështetur fuqimisht veprimtarinë e këtij institucioni në mbrojtjen, krijimin, promovimin e standardeve në fushën e të drejtave themelore të njeriut dhe kontributit të dhënë për përmirësimin e legjislacionit vendas, sipas standardeve ndërkombëtare;

Konstaton se për vitin 2011:

- Avokati i Popullit, në zbatim të rezolutës së Kuvendit të vitit 2011, ka realizuar analiza lidhur me të drejtat e njeriut në vend, duke i prezantuar me të dhëna statistikore për çdo të drejtë.

- Është rritur ndjeshëm numri i çështjeve të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit.

- Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të vitit 2011 për vlerësimin e punës së Avokati të Popullit, është bërë një prezantim më i detajuar, duke analizuar veprime të caktuara të administratave vendore, të kryera në kundërshtim me përcaktimet përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të ligjit nr. 8652, 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

- Numri i rekomandimeve drejtuar administratës publike është më i lartë se vitet e tjera dhe ka një statistikë pozitive lidhur me pranimin e tyre nga organet, të cilave Avokati i Popullit u është drejtuar.

- Problem vazhdon të mbetet numri i çështjeve jashtë juridiksionit që, me gjithë përpjekjet e bëra për të ulur numrin e tyre, përsëri shifra konsiderohet e lartë.

- Rezulton që gjatë vitit 2011, Avokati i Popullit ka zhvilluar një aktivitet më të gjerë

krahasuar me vitet e mëparshme, lidhur me prezencën e tij në median vendore, duke u përpjekur që të sensibilizojë më shumë komunitetin për rolin dhe kompetencat e tij.

- Ka pasur një bashkëpunim formal me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, lidhur me shkeljet e prezumuara ndaj këtyre funksionarëve.

- Ka pasur një rënie të numrit të ankesave në krahasim me vitet e kaluara.

Kërkon nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2012:

- Bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke e informuar më mirë për situatën e të drejtave të njeriut, dhe shkeljet e administratës publike, si dhe konsolidimin e bashkëpunimit me Shërbimin e Monitorimit të Kuvendit, si strukturë administrative, e cila ka si qëllim informimin e Kuvendit.

- Forcimin e paanësisë së institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet përdorimit sa më të efektshëm të mjeteve ligjore, në përmbushje të objektivave për vitin 2012.

- Konsolidimin e bashkëpunimit me Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, dhe Inspektoratin e Ministrisë së Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë, kur konstatohen shkelje.

- Monitorimin e rekomandimeve të bëra për masat e propozuara nga Avokati i Popullit ndaj nëpunësve të administratës publike dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe perfeksionimin e metodologjisë për këtë qëllim.

- Uljen e ankesave jashtë juridiksionit dhe rritjen e numrit të ankesave brenda juridiksionit, nëpërmjet vazhdimit të sensibilizimit të opinionit publik, lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit.

- Në kuadër të funksionit si mekanizëm parandalues, Avokati i Popullit, për vitin 2012, duhet të thellojë hetimet, mbi të cilat mbështet rekomandimet e tij, nisur nga numri i inspektimeve të kryera në funksion të mekanizmit për parandalimin e torturës dhe nga rekomandimet që Avokati i Popullit ka hartuar për këtë qëllim.

14 qershor 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2011

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

- Veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si një institucion i pavarur, i cili, në cilësinë e autoritetit përgjegjës, mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;

- Rritjen e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të opinionit të gjerë publik mbi fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

- Procesin e ndryshimeve të reja që i janë bërë legjislacionit të të dhënave personale, për ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar;

- Përpjekjet e Komisionerit për përmirësimin e performancës së punës, kryesisht në kompetencat e tij inspektuese dhe ankimore.

Konstaton se gjatë vitit 2011:

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përqendruar në fushatën e

ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit, lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri, duke organizuar konferencë kombëtare, seminare, trajnime dhe veprimtari të tjera sensibilizuese, me qëllim njohjen me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, dhe detyrimet ligjore që rrjedhin prej tij.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka ruajtur pothuajse të njëjtin trend me vitin e kaluar, për sa u përket njoftimeve dhe regjistrimeve.

- Ka rritur ndjeshëm performacën e punës në kompetencat e tij shqyrtuese të ankesave, në kompetencat inspektuese dhe në vendosjen e masave administrative në raport me vitin e kaluar.

- Ka filluar punën me riinspektimet, me qëllim verifikimin dhe monitorimin e rekomandimeve të mëparshme në disa kontrollues publikë dhe privatë, lidhur me respektimin e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar.

- Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, ka dhënë mendim për disa projektligje dhe akte nënligjore në fushën e të dhënave personale.

- Ka përgatitur strategjinë e punës për vitet 2012 - 2013, duke përcaktuar përparësitë dhe objektivat që duhet të realizohen në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale përgjatë këtyre viteve.

Për vitin 2012 kërkon:

- Rritjen e numrit të inspektimeve dhe riinspektimeve, me qëllim matjen e nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe zhvillimin e politikave konkrete të inspektimit të subjekteve kontrolluese dhe përpunuese, për të verifikuar kriteret ligjore për përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

- Monitorim në vazhdimësi të veprimtarisë së kontrolluesve dhe përpunuesve të të dhënave personale, duke synuar evidentimin e drejtpërdrejtë të rasteve që cenojnë të dhënat personale të individit, si dhe ndërhyrjen e menjëhershme të Komisionerit për vendosjen e masave administrative ndaj tyre.

- Angazhimin maksimal të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në drejtim të një identifikimi të plotë të subjekteve kontrolluese e përpunuese dhe regjistrimin e tyre në regjistrin e subjekteve kontrolluese.

- Angazhim në vazhdimësi për dhënien e opinioneve ligjore të Komisionerit në përgatitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore, që kanë lidhje me fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

14 qershor 2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr. 7534, datë 11.6.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Giovanni Adelmo Torri
2. Paola Giorgio Castriota Scanderbeg
3. Alessandro Antonio Giorgio Castriota Scanderbeg
4. Giulio Giorgio Castriota Scanderbeg
5. Luan Skënder Shllaku
6. Albina Xhevat Rrahmani
7. Arbnora Musa Robeli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7540, datë 13.6.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Hatixhe Fazli Shala (Rushitoviq)
2. Gjyljeta Ahmet Shala
3. Kushtrim Ahmet Shala
4. Arbenita Ahmet Shala
5. Arbër Ahmet Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7546, datë 22.6.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe neneve 9, 10 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Hysni Ragip Jakupi
2. Fexhri Beqir Koskoviku
3. Zyla Raif Osmanaj (Mjekiqi)
4. Fisnik Safet Çitaku
5. Albërije Metë Hadergjonaj (Ramosaj)
6. Kadri Azem Ahmetoğlu
7. Narasimha Rao VSR Sastry Vajjhala
8. Vlora Ahmet Kame (Delia)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET
Nr. 7551, datë 25.6.2012

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" dhe 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:
1. Rexhep Osman Kodra
2. Naile Hajrë Kodra (Bajraktari)
3. Avni Rexhep Kodra
4. Xhemile Rexhep Kodra
5. Kimete Agush Kodra (Fazliu)
6. Krenare Ilaz Kodra
7. Sumeja Ilaz Kodra
8. Sabit Rifat Kodra
9. Jon Sabit Kodra
10. Tana Sabit Kodra
11. Blerta Gani Deliu-Kodra (Kodra)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM
Nr. 6, datë 15.6.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 28.3.2012 "PËR EKZAMINIMIN E MJETEVE DHE PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATËS SË MIRATIMIT ADR"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, neneve 57 dhe 63 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar; ligjit nr. 9272, datë 16.9.2004 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane "Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR)" dhe protokollin e nënshkrimit", dhe kapitullit IX të urdhëresës së Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 21.8.1998 "Për rregullat e klasifikimit, emërtimit dhe transportit rrugor të mallrave të rrezikshme", Ministri i Punëve Publike dhe Transportit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 28.3.2012 "Për ekzaminimin e mjeteve dhe procedurat për lëshimin e certifikatës së miratimit ADR" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi 1 i nenit 4 ndryshon si më poshtë:

"1. Pronari i mjetit të plotë ose të plotësuar, i cili operon në transportin e mallrave të rrezikshme, aplikon për certifikatën e miratimit ADR të mjetit në Drejtorinë e Regjistrimit dhe të Licencimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).".

Neni 2

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e paragrafit 1 riformulohet si më poshtë:

"b) dorëzon një kopje të certifikatës së lëshuar sipas shkronjës "a" të këtij paragrafi në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve dhe të Licencimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).".

2. Paragrafi 3 riformulohet si më poshtë:

"3 Certifikata e miratimit ADR e lëshuar sipas shkronjës "a" të paragrafit 1 ose raporti i lëshuar sipas paragrafit 2 të këtij neni firmosen nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) ose i autorizuari prej tij.".

Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi 2 riformulohet si më poshtë:

"2. Data e fundit për të kryer një ekzaminim të mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 është 15 ditë nga data e dorëzimit të dokumentacionit në Drejtorinë e Regjistrimit të Mjeteve dhe të Licencimeve të DPSHTRR-së.".

2. Paragrafi 3 riformulohet si më poshtë:

"3. Kur një ekzaminim i mjetit sipas paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 4 nuk është kryer në datën e fundit të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, ekzaminuesi i autorizuar duhet të kthejë

dokumentacionin, përfshirë certifikatën e miratimit ADR të mjetit te Drejtoria e Regjistrimit të Mjeteve dhe e Licencimeve të DPSHTRR-së, sipas paragrafit 3 të nenit 4 jo më vonë se 5 ditë nga data e fundit.".

Neni 4

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

URDHËR
Nr. 4217/2, datë 25.6.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURAT DHE AFATET E ORGANIZIMIT TË PROVIMIT PËR LICENCIMIN E ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar, si dhe të pikës 12 të vendimit nr. 852, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit për licencimin e administratorëve të falimentit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri, që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PROCEDURAT DHE AFATET E ORGANIZIMIT TË PROVIMIT PËR LICENCIMIN E ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës për realizimin e provimit të kualifikimit të administratorëve të falimentit, si dhe rregullave, procedurave dhe kritereve për certifikimin e administratorëve të falimentit.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin e provimit të kualifikimit për fitimin e së drejtës të ushtrimit të veprimtarisë si administrator i falimentit, me qëllim garantimin e një procesi konkurrues, bazuar në parimin e meritokracisë, paanësisë, barazisë midis konkurrentëve dhe ligjshmërisë.

Neni 3
Organi përgjegjës për realizimin e provimit

1. Procedura e provimit organizohet nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë rregullore.
2. Ministri i Drejtësisë, në çdo rast që vlerësohet e nevojshme për plotësimin e numrit të nevojshëm të administratorëve të falimentit, me urdhër të veçantë përcakton datën e provimit të kualifikimit.
3. Urdhri për caktimin e datës, përfshin afatin e nevojshëm për depozitimin e kërkesave dhe dokumentacionit për konkurrim, si dhe periudhën brenda të cilit duhet të kryhet trajnimi paraprak i kandidatëve.
4. Urdhri për datën e provimit, publikohet në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.
5. Çdo person i interesuar mund të kërkojë kopje të urdhrit të Ministrit për datën e provimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

KREU II
PROCEDURAT PARAPRAKE PËR CERTIFIKIMIN E ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

Neni 4
Kandidatët

Kandidatët për ushtrimin e profesionit të administratorëve të falimentit, janë personat fizikë, që janë licencuar si ekspertë në fushën e ekonomisë ose noterët dhe juristët që provojnë se gëzojnë

njohuri në fushën ekonomike dhe që regjistrohen pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit si kandidatë për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit.

Neni 5
Kriteret për kandidatët për administrator falimenti

Kandidati për administrator falimenti duhet të plotësojë këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të mos ketë qenë i dënuar penalisht;

c) të mos ketë detyrime financiare të papaguara pranë organeve tatimore;

d) të ketë përfunduar një program të ciklit të dytë të studimeve, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, në profilin ekonomik dhe/ose juridik;

e) të ketë përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet në fushën e ekonomisë;

f) të shprehë gatishmërinë për ndjekjen e ciklit të plotë të trajnimit paraprak të organizuar nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit;

g) të zotërojë një garanci bankare në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë për të siguruar dëmet që mund t'i shkaktojë të tretëve, si pasojë e veprimtarisë së tij si administrator falimenti;

h) të mos ketë qenë në proces falimentimi ose anëtar i Këshillave Mbikëqyrës apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi ose likuidimi, të paktën për 5 vitet e fundit;

i) të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin e administratorit, ku përfshihet të mos punojë në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit, të mos jetë përmbarues gjyqësor apo të mos ushtrojë çdo profesion tjetër që është i papajtueshëm;

j) të paguajë tarifën e provimit, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë për llogari të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 6
Dokumentacioni i nevojshëm që shoqëron kërkesën e kandidatit

1. Kandidati për administrator falimenti, duhet të shoqërojë kërkesën e tij për përfshirjen në procedurat e kualifikimit për ushtrimin e profesionit të administratorit të falimentit, me dokumente që provojnë plotësimin e kritereve të parashikuara nga kjo rregullore.

2. Kërkesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht identitetin e plotë të kandidatit, adresën postare dhe elektronike, si dhe numrin e kontaktit telefonik. Formati standard i kërkesës miratohet me urdhër të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

3. Kandidati duhet të depozitojë kërkesën e tij të shoqëruar veçanërisht me këto dokumente:

a) kopje të kartës së identitetit ose pasaportës së vlefshme;

b) dëshmi penaliteti;

vërtetim të organeve tatimore se nuk ka detyrime financiare të papaguara;

ç) diplomën, së bashku me listën e notave, të noterizuar, me anë të së cilës provon përfundimin e një prej programeve të ciklit të dytë të studimeve, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

d) CV-në së bashku me dokumentacionin që provon përvojën profesionale prej 10 vitesh në fushën e ekonomisë;

e) deklaratë personale, sipas formatit të miratuar me urdhër të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, me anë të së cilës shpreh gatishmërinë për ndjekjen e ciklit të plotë të trajnimit paraprak;

f) dokumentacion me anë të të cilit provon se zotëron një garanci bankare në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë;

g) dokumentacion që provon se nuk ka qenë në proces falimentimi ose anëtar i Këshillave Mbikëqyrës apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi ose likuidimi, të paktën për 5 vitet e fundit, të lëshuar nga organet kompetente. Në mungesë të tij, një vetëdeklarim, nën përgjegjësi penale, se nuk ka qenë në proces falimentimi ose anëtar i Këshillave Mbikëqyrës apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi ose likuidimi, të paktën për 5 vitet e fundit;

h) dokumentacion që provon pagimin e tarifës së provimit dhe trajnimit për llogari të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit;

i) deklaratë se do të ushtrojë veprimtarinë e administratorit të falimentit në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale;

j) çdo dokument tjetër që kandidati e vlerëson të rëndësishëm për të provuar se plotëson kriteret e parashikuara nga kjo rregullore.

4. Dokumentacioni shoqërues i kërkesës, duhet të jetë në gjuhën shqipe ose me përkthim të certifikuar rregullisht, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të jetë jo më i vonë se 3 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Kandidati është përgjegjës personalisht për vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të depozituar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 7
Depozitimi i kërkesës

1. Kërkesat e kandidatëve depozitohen pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, brenda afatit të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë për caktimin e datës së provimit të kualifikimit.

2. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, çdo kërkesë të depozituar pas afatit të caktuar nga Ministri i Drejtësisë, nuk e merr në shqyrtim dhe ia kthen kandidatit brenda ditës së paraqitjes, duke sqaruar se kërkesa nuk merret në shqyrtim për shkak se është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar.

3. Formati standard i kërkesës është sipas aneksit 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

Neni 8
Shqyrtimi i kërkesës

1. Kërkesat e depozituara pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, brenda ditës së paraqitjes, i dërgohen për shqyrtim strukturës përgjegjëse për licencimin e administratorëve të falimentit, pas regjistrimit të tyre.

2. Struktura përgjegjëse për licencimin e administratorëve të falimentit, brenda 3 ditëve nga marrja në dorëzim e kërkesës, shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe:

a) njofton kandidatin për kualifikimin e tij për pjesëmarrjen në provim, në rast se kandidati plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje. Në këtë rast, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit njofton kandidatin edhe për detyrimin e pjesëmarrjes së detyrueshme në trajnimin paraprak, si dhe datat për zhvillimin e tij;

b) njofton kandidatin për plotësimin e dokumentacionit të paraqitur nëse vlerëson se kandidati potencialisht plotëson kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, duke përcaktuar edhe afatin brenda të cilit kandidati duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar. Nëse kandidati nuk plotëson dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të specifikuar, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit vepron sipas shkronjës “c” të këtij paragrafi. Nëse kandidati plotëson dokumentacionin e kërkuar dhe përmbush të gjitha kriteret për pjesëmarrjen në provimin e kualifikimit, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit, vepron sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi;

c) njofton kandidatin për skualifikimin e tij nga pjesëmarrja në provim, në rast se kandidati nuk plotëson kriteret sipas kësaj rregulloreje. Në këtë rast, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit argumenton shkaqet për skualifikimin e kandidatit, si dhe kriteret që nuk plotësohen prej tij.

3. Të gjitha njoftimet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, pas miratimit, njoftohen me akt shkresor të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, si dhe njëkohësisht në rrugë elektronike nga një nëpunës i autorizuar prej tij, i cili specifikon edhe numrin dhe datën e aktit shkresor të Drejtorit.

Neni 9
Ankimi

1. Kundër vendimit të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit mund të bëhet ankim, brenda 2 ditëve, te Ministri i Drejtësisë.

2. Ministri i Drejtësisë shprehet për ankimin brenda 2 ditëve. Vendimi i ministrit për pranimin apo rrëzimin e ankimit, i njoftohet ankuesit dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 10
Publikimi i listës dhe i kalendarit të trajnimit paraprak

1. Në përfundim të afatit të ankimit dhe pas shqyrtimit të të gjitha ankimeve nga Ministri i Drejtësisë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit publikon në faqen e saj zyrtare në internet, listën përfundimtare të kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në trajnimin paraprak.

2. Njoftimi i listës përfundimtare shoqërohet edhe me njoftimin e kalendarit të trajnimeve paraprake.

Neni 11
Trajnimi

1. Trajnimet paraprake organizohen nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit dhe synojnë përgatitjen e kandidatëve për administrator falimenti me njohuritë e përgjithshme për ushtrimin e funksionit.

2. Programi i trajnimit paraprak dhe kohëzgjatja e tij, përcaktohet me urdhër të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

3. Programi i trajnimit u vihet në dispozicion kandidatëve, së bashku me njoftimin për kualifikimin për pjesëmarrje në provim.

Neni 12
Përfundimi i trajnimit

1. Përfundimi me sukses i trajnimit përcaktohet nga Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, mbi bazën e rregullave të përcaktuara paraprakisht prej tij.

2. Përfundimi me sukses i trajnimit paraprak është kusht për pjesëmarrjen e kandidatit në provimin e kualifikimit.

KREU III
PROCESI I PROVIMIT

Neni 13
Provimi i kualifikimit

Provimi i kualifikimit të administratorëve të falimentit zhvillohet në datën e caktuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në çdo rast që vlerësohet e nevojshme nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit për plotësimin e numrit të mjaftueshëm të administratorëve të falimentit.

Neni 14
Rregullat e provimit

1. Të gjithë kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në provim, duhet të njihen me rregullat e provimit dhe të nënshkruajnë deklaratën për këtë qëllim. Mos plotësimi i deklaratës apo shkelja e rregullave të parashikuara në këtë urdhër, passjell skualifikimin e menjëhershëm të kandidatit nga procesi i provimit.

2. Rregullat e provimit përcaktohen në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje dhe që është pjesë përbërëse e saj.

Neni 15
Hartimi i tezës së provimit

1. Hartimi i tezës përfundimtare të provimit, bëhet nga Komisioni i Hartimit të Tezës, i cili ngrihet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, jo më parë se ora 20:00 e një dite përpara datës së provimit. Në këtë urdhër përcaktohen detyrat dhe masa e shpërblimit për anëtarët e Komisionit të Hartimit të Tezës.

2. Komisioni i Hartimit të Tezës harton tezën përfundimtare të provimit, duke filluar nga ora 22:00 e ditës përpara datës së provimit. Teza përfundimtare e provimit duhet të jetë gati brenda orës 08:30 të datës së provimit.

3. Komisionit të Hartimit të Tezës i vihet në dispozicion nga Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, baza e nevojshme materiale për hartimin e tezës përfundimtare. Në sallën e hartimit të tezës përfundimtare të provimit, është e ndaluar të ketë pajisje të komunikimit elektronik, si dhe çdo material tjetër të ndryshëm nga ato të vëna në dispozicion nga Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

4. Anëtarët e Komisionit të Hartimit të Tezës nuk duhet të dalin nga salla e hartimit të tezës, deri në momentin që njoftohen nga personi i autorizuar nga Ministri i Drejtësisë se ka filluar provimi i kualifikimit. Asnjë person i paautorizuar nuk mund të futet në sallën e hartimit të tezës. Çdo komunikim i anëtarëve të Komisionit të Hartimit të Tezës për nevojat e tyre gjatë procesit të hartimit të tezës do të bëhet me Drejtorin e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit ose një person të autorizuar prej tij.

5. Anëtarët e Komisionit të Hartimit të Tezës janë të detyruar të mos japin asnjë informacion mbi tezën që është në proces hartimi dhe që miratohet përfundimisht prej tyre. Anëtarëve të Komisionit të Hartimit të Tezës u ndalohet të komunikojnë, në çfarëdolloj forme, me çdo person të tretë jashtë përbërjes së Komisionit. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen passjell përgjegjësi sipas ligjit.

6. Teza e provimit duhet t'i përmbahet programit të provimit, të përcaktuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë për caktimin e datës së provimit. Teza e provimit duhet të përmbajë pyetje që testojnë njohuritë teorike dhe praktike të kandidatit. Komisioni i Hartimit të Tezës është i vetmi autoritet që ka të drejtë të përcaktojë përmbajtjen përfundimtare të tezës së provimit. Teza përfundimtare e provimit miratohet nga ana e të gjithë anëtarëve të Komisionit të Hartimit të Tezës. Teza e provimit vlerësohet maksimalisht me 100 pikë.

Neni 16
Administratorët e provimit

1. Administratorët e provimit caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë dhe kujdesen për hyrjen e kandidatëve në ambientet e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë, kontrollit të tyre dhe marrjes në dorëzim të sendeve të ndaluara, futjen dhe sistemimin e kandidatëve në sallë, kryerjen e procesit të shpërndarjes së materialeve të nevojshme për provim, si dhe shumëfishimin e tezës. Një

nga administratorët e provimit, nën shoqërimin e punonjësit të Ministrisë së Drejtësisë, me uniformë, merr në dorëzim nga Komisioni i Hartimit të Tezës, zarfin e mbyllur ku gjenden pyetjet e provimit. Zarfi hapet në praninë e të gjithë konkurrentëve. Në përfundim të procesit, anëtarët e grupit të punës përpilojnë dhe nënshkruajnë procesverbalin e pjesëmarrjes së kandidatëve. Detyrat dhe përgjegjësitë për secilin nga administratorët e provimit caktohen nga Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

2. Një nga administratorët e provimit, caktohet nga Ministri i Drejtësisë, si person i autorizuar për kryerjen e procesit të sekretimit të fletëve të provimit të kandidatëve. Gjatë procesit të sekretimit, personi i autorizuar për realizimin e tij, kujdeset për ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të kandidatit, duke e realizuar procesin e sekretimit sipas kësaj procedure:

a) fillimisht kryhet procesi i sekretimit të fletës së parë të provimit, ku kandidati ka shënuar identitetin e tij. Në përfundim të procesit të provimit, personi i autorizuar pasi merr në dorëzim nga administratorët e provimit fletët e provimit, me identitetin e fshehtë të kandidatit, nën mbikëqyrjen e tyre, kryen procesin e kodimit të fletës së parë dhe testit të kandidatit;

b) fletët e para të provimit shkëputen nga testi dhe pasi futen në një zarf të mbyllur në mënyrë të sigurt, depozitohen për ruajtje në kasafortë;

c) të gjitha testet futen në një zarf të veçantë të mbyllur në mënyrë të sigurt dhe depozitohen për ruajtje në kasafortë;

d) testet që ndodhen të mbyllura në kasafortë, merren në dorëzim nga Kryetari i Komisionit të Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit, i cili pasi verifikon rregullshmërinë e tyre vendos hapjen e zarfit dhe fillimin e procesit të vlerësimit të testeve;

dh) zarfi me fletët e para të testit, ku gjendet identiteti i fshehur i kandidatit, nxirret nga kasaforta vetëm pasi Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit të ketë depozituar procesverbalin nr. 1, me vlerësimin e secilit prej kandidatëve, sipas kodit të tyre.

Neni 17

Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit

1. Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit, ngrihet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, jo më parë se data e caktuar për zhvillimin e provimit.

2. Komisioni, menjëherë sapo merr në dorëzim tezat e provimit, fillon korrigjimin e tyre, bazuar në parimin e anonimatit të kandidatit, paanësisë dhe objektivitetit.

3. Pas miratimit të vlerësimit përfundimtar për secilin nga kandidatët, Komisioni bën hedhjen e rezultateve të provimit, duke shënuar kodin e kandidatit dhe pikët e marra nga kandidati.

4. Procesverbali me këto rezultate hartohet në dy kopje, ku njëra mbahet nga Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit dhe një kopje i dorëzohet menjëherë Ministrit të Drejtësisë, si dhe nënshkruhet rregullisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

5. Ministri i Drejtësisë, pasi verifikon që të gjitha rezultatet e provimit janë hedhur në procesverbalin e koduar, hap kasafortën ku mbahen fletët me identitetin e fshehur të kandidatit dhe i dorëzon Komisionit të Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit, zarfin me fletën e parë të testit, ku gjendet identiteti i fshehur i kandidatëve.

6. Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit, pasi merr zarfin ku janë futur fletët e para të testit, ku gjendet identiteti i fshehur i kandidatëve, vijon procesin e hapjes së secilës prej fletëve, ku gjendet i fshehur identiteti i kandidatit dhe përpilon listën përfundimtare të rezultateve.

7. Lista përfundimtare e rezultateve hartohet në dy kopje, ku njëra mbahet nga Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit dhe një kopje i dorëzohet menjëherë Ministrit të Drejtësisë, si dhe nënshkruhet rregullisht nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

8. Procesi i vlerësimit përfundon brenda ditës.

Neni 18
Shpallja e rezultateve

1. Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit, brenda 3 ditëve pune, publikon në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë rezultatet e provimit.

2. Data e publikimit të rezultateve të provimit njoftohet në faqen zyrtare në internet të Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 19
Ankimet

1. Kandidatët mund të paraqesin ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, brenda 2 ditëve nga momenti i publikimit të rezultateve të provimit.

2. Ministri i Drejtësisë shqyrton ankimin brenda 2 ditëve dhe vendos pranimin apo rrëzimin e tij.

3. Vendimi i Ministrit të Drejtësisë i njoftohet ankuesit dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 20
Miratimi përfundimtar i fituesve

1. Në përfundim të afatit të ankimit dhe pas shqyrtimit të të gjitha ankimeve, Ministri i Drejtësisë miraton listën e kandidatëve fitues.

2. Fitues janë kandidatët që kanë marrë jo më pak se 70 pikë dhe që kanë siguruar më shumë pikë midis kandidatëve të tjerë.

KREU IV
PROCESI I CERTIFIKIMIT TË ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

Neni 21
Pajisja e kandidatëve fitues me licencën e administratorit të falimentit

1. Pas miratimit të listës së fituesve nga Ministri i Drejtësisë, Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit merr masat e nevojshme për pajisjen e fituesve me licencën e administratorit të falimentit.

2. Pajisja me licencë i jep të drejtë fituesit që të ushtrojë veprimtarinë e administratorit të Falimentit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 22
Licenca e administratorit të falimentit

1. Licenca e administratorit të falimentit është e patransferueshme, e patjetërsueshme, e patregtueshme dhe me afat 2-vjeçar, me të drejtë rinovimi në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë rregullore.

2. Licenca e administratorit të falimentit jepet vetëm pas pagimit të tarifës së pajisjes me licencë, në masën e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Formati dhe elementet përbërëse të licencës miratohen me urdhër të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 23
Hyrja në fuqi e licencës

Licenca hyn në fuqi vetëm pas regjistrimit të saj në Regjistrin e Administratorëve të Certifikuar të Falimentit.

Neni 24
Statusi i licencës

1. Bazuar në veprimtarinë e përditshme që administratori i falimentit realizon, licenca me të cilën ai është pajisur nga Agjencia, mund të jetë në status aktiv ose status joaktiv.
2. Licenca gëzon statusin aktiv kur titullari i saj deklaron gatishmërinë për të ushtruar të gjitha funksionet e administratorit të falimentit dhe përfshihet në listën e administratorëve që ushtrojnë efektivisht funksionin.
3. Licenca gëzon statusin joaktiv kur titullari i saj nuk deklaron gatishmërinë për të përmbushur funksionet e administratorit dhe nuk kryen asnjë nga funksionet e administratorit të falimentit.
4. Për të aktivizuar licencën joaktive, brenda periudhës 2-vjeçare nga data e lëshimit të saj, administratori duhet të provojë që vazhdon të përmbushë kriteret për ushtrimin e funksionit të administratorit të falimentit.
5. Në rast se administratori i falimentit e ka mbajtur licencën me status joaktiv gjatë gjithë periudhës 2-vjeçare, licenca e tij nuk mund të rinovohet në përfundim të afatit të vlefshmërisë dhe personi duhet t'i nënshtrohet përsëri provimit të kualifikimit.
6. Statusi i licencës shënohet në Regjistrin e Administratorëve të Certifikuar të Falimentit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

Neni 25
Regjistrimi i administratorëve të falimentit

1. Administratorët e falimentit regjistrohen në Regjistrin e Administratorëve të Certifikuar të Falimentit, si dhe lista e tyre publikohet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.
2. Të dhënat e administratorëve të certifikuar të falimentit, të cilët kanë licencë me status aktiv, depozitohen në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit.

Neni 26
Njoftimi i ndryshimeve

1. Administratori, i cili ndryshon vendbanimin ose ndonjë nga kushtet për ushtrimin e funksionit të administratorit të falimentit ka detyrimin të njoftojë Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit.
2. Çdo ndryshim pasqyrohet në Regjistrin e Administratorëve të Certifikuar të Falimentit.

Neni 27
Rinovimi i licencës

1. Licenca do të rinovohet në bazë të kërkesës me shkrim të administratorit të falimentit, e cila do të depozitohet në Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit, jo më vonë se 30 ditë kalendarike para datës së skadimit të licencës.

2. Kërkesa duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin;

b) numrin e kartës së identitetit;

c) adresën e vendbanimit.

3. Kërkesa duhet të shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

a) deklaratën e aplikuesit se ai/ajo vazhdon të plotësojë kriteret për mbajtjen e licencës. Në rast të ndonjë ndryshimi, administratori i falimentit duhet të dorëzojë dokumentet që evidentojnë këto ndryshime në përputhje me këtë rregullore;

b) të dhënat e aktiviteteve që administratori ka kryer në fushën e falimentit gjatë dy viteve paraardhëse;

c) dëshminë se ka marrë pjesë çdo vit në të gjitha trajnimet vazhduese profesionale dhe/ose kurset në fushën e falimentit të organizuara nga Agjencia;

d) deklaratën se gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës, aplikanti nuk ishte subjekt i ndonjë mase disiplinore;

e) vërtetimin që ka paguar të gjitha detyrimet, e përcaktuara nga Agjencia gjatë procedurës së mbikëqyrjes profesionale;

f) dokumentin që provon se ka paguar tarifat për shqyrtimin e aplikimit dhe për rinovimin e licencës.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 28
Dispozitë e fundit

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Neni 29
Hyrja në fuqi e rregullores

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Ministri i Drejtësisë dhe publikohet në faqen zyrtare në internet të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit.

ANEKSI 1
RREGULLAT E PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT TË ADMINISTRATORËVE TË FALIMENTIT

Rregulli 1
Paraqitja e kandidatëve ditën e provimit

1.1. Kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në provim, paraqiten ditën e provimit në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë me mjet identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë të vlefshme).

1.2. Hyrja për në ambientet e brendshme të Ministrisë së Drejtësisë do të bëhet nga hyrja nr. 2 – Zyra e Pritjes me Popullin, duke filluar 1 orë përpara orës së njoftuar për fillimin e provimit.

1.3. Kandidatët në mënyrë të rregullt paraqiten përpara nëpunësve të Ministrisë së Drejtësisë, duke i treguar kartën e identitetit.

1.4. Kandidati i kualifikuar për të marrë pjesë në provim, duhet të deklarojë nëse është apo jo i pajisur me mjete të tilla, si: çantë, dosje, laps ose stilolaps, mjete elektronike apo telefonike, të cilat nuk lejohen në sallën e provimit. Nëse ai është i pajisur me mjete të tilla, duhet t'i lërë për ruajtje këto sende pranë punonjësve të caktuar për këtë qëllim.

Rregulli 2
Sistemimi në sallë

2.1. Kandidatët ftohen të zënë vendet sipas një përzgjedhjeje rastësore të caktuar nga administratorët e provimit dhe për asnjë arsye nuk mund të ndryshojnë vendin e caktuar.

2.2. Pas sistemimit në sallë të të gjithë kandidatëve, fakt ky i cili deklarohet zyrtarisht nga administratorët e provimit, për asnjë arsye kandidati nuk lejohet të dalë jashtë saj dhe asnjë person i paautorizuar nuk lejohet të futet në sallën e provimit, përfshirë këtu edhe kandidatë, të cilët janë paraqitur jashtë afatit të përcaktuar për hyrjen në sallë.

Rregulli 3
Njohja me rregullat e provimit

3.1. Administratorët e provimit, gjatë procesit të shumëfishimit të tezës, njoftojnë kandidatët për rregullat e provimit, si dhe i fton ata t'i lexojnë këto rregulla në dokumentin e shpërndarë për këtë qëllim.

3.2. Pas njoftimit mbi rregullat e provimit, kandidati ftohet të plotësojë një deklaratë me shkrim, sipas modelit bashkëlidhur, se u njoh me rregullat, i pranon ato dhe se është i ndërgjegjshëm se shkelja e tyre përbën shkak për skualifikimin e menjëhershëm nga provimi.

3.3. Refuzimi për nënshkrimin e deklarimit apo kundërshtimi i përmbajtjes së tij, passjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të kryer konkurrimin.

Rregulli 4
Kohëzgjatja e provimit

Kohëzgjatja e provimit përcaktohet në tezën e provimit nga Komisioni i Hartimit të Tezës.

Rregulli 5
Detyrimet e kandidatit

5.1. Kandidati ndalohet të mbajë me vete në sallën e provimit telefon celular apo mjet tjetër komunikimi elektronik, dokument të shkruar apo elektronik.

5.2. Kandidatit i ndalohet të flasë me kolegët apo persona të tjerë në sallë, me çfarëdolloj forme apo mënyre. Komunikimi, si dhe marrja apo dhënia e ndihmës i skualifikon automatikisht të dy kandidatët.

5.3. Kandidatit i ndalohet të dalë nga salla e provimit për çfarëdolloj arsyeje.

5.4. Gjatë provimit, kandidatët nuk lejohen të shënojnë ose lënë emrin, të bëjnë shenja sado të vogla, shprehje apo citime në tezën e provimit, të cilat mund ta bëjnë kandidatin të identifikueshëm. Shenjat që do të vlerësohen si mundësi identifikimi vendosen rast pas rasti nga Komisioni i Kualifikimit të Administratorëve të Falimentit dhe mund të përfshijnë, por pa u kufizuar:

a) shkrimin e të gjithë provimit ose një pjese të tij me germa kapitale;

b) nënvizimin e fjalëve apo shprehjeve;

c) përdorimin e emrave të personave të ndryshëm;

d) përdorimin e të dhënave identifikuese që lidhen me punën e kandidatit, familjen, shkollën që ka ndjekur.

Nëse konstatohen shenja të ndryshme në fletën e provimit, ato do të shpallen të pavlefshme dhe kandidati skualifikohet nga konkurrimi.

5.5. Në rast se teza e provimit do të përmbajë pyetje me zhvillim, në rast korrigjimi të një fjale apo shprehjeje, kandidati duhet ta fusë atë në kllapa dhe t'i kalojë një vizë sipas fjalës apo shprehjes së hequr {për ilustrim-(gabim)}.

Nëse teza do të përmbajë pyetje me alternativa, kandidati duhet të rrethojë saktë vetëm njërën prej tyre. Korrigjimi i mëvonshëm apo shënimi i më shumë se një alternative e bën përgjigjen automatikisht të pasaktë.

5.6. Gjatë plotësimit të tezës së provimit të mos lihen hapësira boshe midis rreshtave dhe të mos përdoren baza të tjera materiale veç atyre të vëna në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë.

Rregulli 6
Përgjegjësia në rast shkeljeje të rregullave

6.1. Shkelja e rregullave të provimit nga kandidatët passjell automatikisht skualifikimin e tyre nga procesi i konkurrimit.

6.2. Administratorët e provimit, në rast të konstatimit të shkeljes së rregullave të përcaktuara në këtë rregullore, i kërkojnë pa paralajmërim kandidatit lënien menjëherë të sallës së provimit, duke i komunikuar edhe skualifikimin nga procedura e konkurrimit. Për këtë qëllim, administratorët e provimit mbajnë një procesverbal, ku shënojnë emrin e kandidatit të skualifikuar, nxjerrjen jashtë procesit të vlerësimit të tezës së tij, si dhe shkaqet që kanë çuar në skualifikimin e kandidatit. Procesverbali i skualifikimit nënshkruhet nga të gjithë administratorët e provimit dhe bëhet pjesë e dosjes mbi procedurat e zhvilluara, duke i bashkëlidhur edhe tezën e tij të provimit.

Rregulli 7
Garantimi i barazisë midis kandidatëve

7.1. Në funksion të garantimit të barazisë midis kandidatëve dhe paanësisë në procesin e vlerësimit, teza e provimit vlerësohet duke ruajtur anonimatin e kandidatit.

7.2. Në funksion të ruajtjes së anonimatit, teza e provimit i nënshtrohet procesit të sekretimit, sipas udhëzimeve të dhëna për këtë qëllim, stafit teknik të sekretimit.

7.3. Kandidati duhet të plotësojë vetëm fletën e parë të provimit, në rubrikat që përmban ajo për këtë qëllim. Shënimi i emrit jashtë kësaj rubrike passjell skualifikimin e menjëhershëm të kandidatit. Fleta e parë me identitetin e fshehur të kandidatit mbahet në një kasafortë të posaçme.

7.4. Administratorët e provimit nuk duhet të kenë profil jurist.

Rregulli 8
Publikimi i rezultateve

Publikimi i rezultateve bëhet jo më vonë se 5 ditë nga momenti i zhvillimit të provimit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DEKLARATË

Sot, më datë ____/____/2012, ora ____,

Unë _____, pjesëmarrës në provimin e kualifikimit për administrator falimenti, pasi u njoha me rregullat e provimit, të miratuara me urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, bashkëlidhur kësaj deklarate, me vullnet të plotë deklaroj se:

U NJOHA ME RREGULLAT E PROVIMIT, I KUPTOVA ATO, JAM DAKORD TË KRYEJ PROVIMIN SIPAS TYRE, SI DHE JAM I/E NDËRGJEGJSHËM/ME SE SHKELJA E TYRE PASSJELL SKUALIFIKIMIN E MENJËHERSHËM NGA PROVIMI.

Tiranë, më ____ / ____ / 2012

_____
(emër, mbiemër)
(nënshkrim i kandidatit)

ANEKSI 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___/___/ 2012

FORMULAR APLIKIMI

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Emri _____ Mbiemri _____

Datëlindja ____ / ____ / _____ Vendlindja _____

Shtetësia _____

Kompania nëse jeni i punësuar _____

Adresa e zyrës _____ Nr. telefoni, fax _____ Adresë email _____

_____ _____ _____

Adresa e banimit _____ Nr. telefoni, fax _____ Adresë email _____

_____ _____ _____

Punëdhënësi aktual (nëse keni) _____ Nr. i telefonit, fax i punëdhënësit _____

Data e fillimit të veprimtarisë/ushtrimit të profesionit:

____ / ____ / _____

Organizata apo shoqata profesionale nëse jeni i anëtarësuar _____

DEKLARIME NË LIDHJE ME PROFESIONIN

Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se:
a) Nuk kam kaluar personalisht në procedura falimenti gjatë 5 viteve të fundit. ☐
b) Nuk kam qenë anëtar i këshillave mbikëqyrëse apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi apo likuidimi gjatë 5 viteve të fundit. ☐

DEKLARIME PERSONALE

Deklaroj me vullnet të lirë e të plotë se:

a) Jam i padënuar penalisht. ☐
b) Jam i dënuar penalisht. ☐

DEKLARIME MBI PËRDORIMIN E LICENCËS

Për licencën e lëshuar nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Falimentit, pranoj kushtin e mëposhtëm:

a) Të jetë aktive për një periudhë 2-vjeçare, duke administruar gjatë kësaj periudhe minimalisht 1 (një) çështje falimenti.

b) Për çdo ndryshim të vendbanimit apo vendit të ushtrimit të veprimtarisë do të informojë paraprakisht me shkrim Agjencinë për çdo ndryshim të tillë.

PO ☐ JO ☐

Bashkëlidhur këtij aplikimi do të bashkëngjitet dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

Nr.	**Dokumentet**	**PO**	**JO**
1	Kopje të kartës së identitetit ose pasaportës së vlefshme		
2	Dëshmi penaliteti		
3	Vërtetim të organeve tatimore se nuk ka detyrime financiare të papaguara		
4	Diplomën, së bashku me listën e notave, të noterizuar, me anë të së cilës provon përfundimin e një prej programeve të ciklit të dytë të studimeve, sipas legjislacionit për arsimin e lartë		
5	CV-në së bashku me dokumentacionin që provon përvojën profesionale prej 10 vitesh në fushën e ekonomisë		
6	Deklaratë personale, sipas formatit të miratuar me urdhër të Drejtorit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit, me anë të së cilës shpreh gatishmërinë për ndjekjen e ciklit të plotë të trajnimit paraprak		
7	Dokumentacion me anë të së cilit provon se zotëron një garanci bankare në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë		

8	Dokumentacion që provon se nuk ka qenë në proces falimentimi ose anëtar i Këshillave Mbikëqyrës apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi ose likuidimi, të paktën për 5 vitet e fundit, të lëshuar nga organet kompetente. Në mungesë të tij, një vetëdeklarim, nën përgjegjësi penale, se nuk ka qenë në proces falimentimi ose anëtar i këshillave mbikëqyrës apo drejtues i shoqërive në proces falimentimi ose likuidimi, të paktën për 5 vitet e fundit		
9	Dokumentacion që provon pagimin e tarifës së provimit dhe trajnimit për llogari të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit		
10	Deklaratë se do të ushtrojë veprimtarinë e administratorit të falimentit në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale		

Deklarimi mbi nënshkrimin

Unë i nënshkruari _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë formular, janë të vërteta dhe për këtë autorizoj Agjencinë e Mbikëqyrjes së Falimentit në verifikimin e tyre.

_____ Tiranë, më ____/____/_____/
Emër/mbiemër/firmë

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 11.7.2012
Doli nga shtypi më 13.7.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë